

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Investigimi tronditës: Netanyahu u paralajmërua për sulmin e 7 tetorit, por nuk reagoi! Zyra e kryeministri t e mohon: Gënjeshtër – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/investigimi-trondites-netanyahu-u-paralajmerua-per-sulmin-e-7-tetorit-por-nuk-reagoi-zyra-e-kryeministrit-e-mohon-genjeshter/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	8 shtator 2026, 16:53:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 10:35:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e7a04e9abeb1c849158486d292284e126118756530e6650382a15edcf70bf50d
TEKSTI	967f826bda5ef21308839796181f4af5144cc26673c285902157875b5ada348f
PAMJA	a96ce7af382d4e277d18a825e666b148d208c7c6e2e254023a67950551d442b0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bc3242ef86bfd6df16ba77a8cf2f838fd66d5a193dbc75c2a7c805072d99ee17
E MËPARSHMJA	37f389d8047585d499c702cde585dc73d43f34815d17422ff2a555a604e865af
RRËNJA MERKLE	7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bc3242ef86bfd6df16ba77a8cf2f838fd66d5a193dbc75c2a7c805072d99ee17>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Një pretendim i rëndësishëm lidhur me atë që i parapriu sulmit të Hamasit ndaj Izraelit më 7 tetor 2023 është publikuar nga gazeta izraelite [Haaretz](#). Sipas një hetimi të saj, presidenti i Emirateve të Bashkuara Arabe, Mohamed bin Zayed, kishte paralajmëruar personalisht kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu se lideri i atëhershëm i Hamasit në Gaza, Yahya Sinwar, po përgatiste një operacion të madh kundër Izraelit.

Sipas raportimit, paralajmërimi është bërë rreth dhjetë ditë para sulmit të 7 tetorit. Netanyahu, megjithatë, dyshohet se e kishte nënvlerësuar informacionin, duke vlerësuar se Hamasi mund të kishte në fokus kryesisht Bregun Perëndimor dhe duke e siguruar liderin e Emirateve se Izraeli ishte i përgatitur për çdo kërcënim.

Zyra e Netanyahu i ka mohuar kategorikisht këto pretendime, duke deklaruar se një bisedë e tillë nuk ka ndodhur.

Biseda 45-minutëshe dhe paralajmërimi për Sinwarin

Sipas Haaretz, e cila citon tre burime të huaja të nivelit të lartë me dijeni për përmbajtjen e bisedës, Mohamed bin Zayed kontaktoi Netanyahu rreth dhjetë ditë para 7 tetorit. Biseda thuhet se zgjati rreth 45 minuta.

Gjatë bisedës, presidenti i Emirateve dyshohet se paralajmëroi Netanyahu se Yahya Sinwar po përgatiste një operacion të madh. Ai shprehu shqetësimin se një sulm i tillë mund të shkaktonte një gjakderdhje të madhe, të destabilizonte rajonin dhe të dëmtonte marrëdhëniet e krijuara përmes Marrëveshjeve të Abrahemit, të cilat kishin sjellë normalizimin e

5 Elbasani nuk tanëgnatja peson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

marrednenieve mes Izraelit dhe disa shteteve arabe.

Sipas gazetës, Netanyahu iu përgjigj se besonte se Hamasi ishte më i përqendruar te Bregu Perëndimor dhe e siguroi bin Zayed se Izraeli ishte në gjendje të përballonte çdo kërcënim.

Edhe Egjipti dyshohet se kishte paralajmëruar Netanyahun

Sipas hetimit të Haaretz, Emiratet e Bashkuara Arabe nuk ishin i vetmi shtet që tentoi të paralajmëronte Izraelin.

Rreth së njëjtës periudhë, kreu i inteligjencës egjiptiane, Abbas Kamel, dyshohet se kontaktoi Netanyahun dhe e paralajmëroi se Hamasi po përgatiste “diçka të pazakontë, një operacion të frikshëm”.

Sipas raportimit, Netanyahu u përgjigj se situata në Gaza ishte nën kontroll dhe se Izraeli në atë periudhë kishte përqendruar vëmendjen dhe një pjesë të konsiderueshme të forcave ushtarake në Bregun Perëndimor.

Gazeta pretendon se as paralajmërimi nga Emiratet dhe as ai nga Egjipti nuk u përmendën nga Netanyahu në një takim të mëvonshëm, më 1 tetor 2023, vetëm gjashtë ditë para sulmit, ku u diskutua situata në Gaza dhe kërcënimi nga Hamasi.

Një zyrtar i lartë i Shin Bet, i cituar nga gazeta, vlerëson se nëse shërbimet e sigurisë do të kishin pasur dijeni për këto paralajmërime, mund t'i kishin interpretuar ndryshe sinjalet e mëparshme të Sinwarit dhe qëndrimin e Hamasit në negociata.

Zyra e Netanyahut: Gënjeshërë flagrante

Zyra e kryeministrit izraelit i ka hedhur poshtë të gjitha pretendimet e publikuara nga Haaretz.

“Gënjeshërë flagrante. Kryeministri Netanyahu nuk ka folur me presidentin e Emirateve të Bashkuara Arabe gjatë kësaj periudhe dhe nuk ka marrë asnjë paralajmërim prej tij”, thuhet në reagimin e zyrës së kryeministrit.

Sipas Haaretz, Mohamed bin Zayed nuk iu përgjigj kërkesës së gazetës për koment mbi raportimin.

Publikimi i hetimit ka shkaktuar menjëherë reagime politike në Izrael.

Ish-kryeministri Naftali Bennett deklaroi se e di “si fakt” se informacioni është i vërtetë. Sipas tij, si Mohamed bin Zayed, ashtu edhe kreu i inteligjencës egjiptiane, Abbas Kamel, e kishin paralajmëruar Netanyahun për një operacion të madh të Hamasit përpara 7 tetorit.

Bennett kritikoi ashpër kryeministrin aktual, duke e akuzuar se kishte mbetur i mbërthyer në bindjen se Hamasi mund të kontrollohej dhe se nuk kishte reaguar në mënyrë të mjaftueshme ndaj paralajmërimeve.

#hamas

#izrael



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh






BOTA

Trump i
kërkon Zelenskyt të...

Xhuljana
Zhuleku

21 minuta
më parë




BOTA

Tragjedi! Përmbysset
anija me pasagjerë,...

Xhuljana
Zhuleku

Dje
23:17



BOTA

Zjarr masiv në Kroaci,
evakuohen 230...

Xhuljana
Zhuleku

Dje
19:36



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë

Bota

Vendi

Kronikë

Lifestyle

Programe

Programe

Seriale

Guida TV

Video

Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh

Karriera

Kontakt

Reklamo me ne

Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit

Privatësia

Cookies

Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.